ЦЕНТАР ЗА РАЗВОЈ НА
ЈУГОЗАПАДНИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН
QENDËRA PËR ZHVILLIM
TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR
Бр./Nr. 01-40/1
06.03.2026 год./vit.

Врз основа на член 22 и 23, а во врска со член 30, точка 1, алинеја 6 од Законот за рамномерен регионален развој на РС Македонија („Службен весник на РСМ“, бр. 24/2021, 174/21 и 241/24), и врз основа на членот 2, точка 1, алинеја 9 од Деловникот за работа на Советот за развој на Југозападниот плански регион, Советот за развој, на својата втора седница, одржана на 06.03.2026 година, ја донесе следнава

Në bazë të nenit 22 dhe 23, dhe në lidhje me nenin 30, paragrafi 1, alineja 6 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.24/2021, 174/21 dhe 241/24), dhe në bazë të nenit 2, paragrafi 1, alineja 9 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Këshilli për zhvillim, në mbledhjen e dytë, e mbajtur në datë 06.03.2026, e solli këtë:

## ОДЛУКА

**Член 1**

Се усвојува Годишниот извештај за реализација на Програмата за развој на Југозападниот плански регион за 2025 година со интегриран Финансиски извештај за 2025 година.

**Член 2**

Составен дел на оваа Одлука е Годишниот извештај за реализација на Програмата за развој на Југозападниот плански регион за 2025 година со интегриран Финансиски извештај за 2025 година.

**Член 3**

Оваа Одлука влегува во сила со денот на нејзиното усвојување.

## VENDIM

**Neni 1**

Miratohet Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2025 me Raport financiar të integruar për vitin 2025.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2025 me Raport financiar të integruar për vitin 2025.

**Neni 3**

Ky Vendim hynë në fuqi prej ditës që është miratuar.

СОВЕТ ЗА РАЗВОЈ НА ЈУГОЗАПАДЕН ПЛАНСКИ РЕГИОН
Претседател
Кирил Пецаков

KËSHILLI PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR
President,
Kiril Pecakov

Струга, 06.03.2026 Strugë, 06.03.2026

# RAPORT VJETOR
# PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT
# PËR ZHVILLIM TË
## RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR
## PËR VITIN 2025

Në bazë të nenin 22 paragrafi 2, neni 30 paragrafi 1 alineja 6, neni 32 dhe neni 65 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (Gazeta zyrtare e RMV, nr.24/21, 174/21 dhe 241/24), Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti, ndërsa Këshilli për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e miratoi këtë:

# RAPORT VJETOR

# PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR 2021-2026

# PËR VITIN 2025

Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e përfshin periudhën janar-dhjetor të vitit 2025.

## REZIME


Programi për zhvillim i rajonit planor Jugperëndimor është dokument bazik afatmesëm, i cili bazën juridike e ka në Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal (nenet 13,14,15), është përgatitur me qëllim që të zvogëlohen dallimet mes rajoneve planore, si edhe në vet rajonin, dhe të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm përmes shfrytëzimit të gjithë potencialeve në dispozicion.

Operacionalizimi i Programit në nivel vjetor bëhet përmes Planit aksionar, ku realizimi i tij është bazë për realizimin e qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara në Programin për zhvillim të rajonit planor, gjegjësisht në aspektin ekonomik, infrastrukturor, zhvillimi rural, turizmi dhe kultura, si edhe arsimi edhe çështjet sociale dhe aspektet e tjera të zhvillimit në RPJP.

Në Plani i Aksionar për vitin 2025 janë planifikuar 28 aktivitete projektuale që duhej të realizoheshin nga Qendra për Zhvillim, komunat dhe ndërmarrjet publike komunale brenda rajonit planor Jugperëndimor. Nga këto, janë realizuar 23 aktivitete gjatë vitit 2025, që korrespondon me një nivel realizimi prej 82,15%. Sipas qëllimeve strategjike, për qëllimin strategjik 1 ishin parashikuar 19 aktivitete dhe nga këto u realizuan 14 aktivitete, ose 73,6%. Për qëllimin strategjik 2 ishin parashikuar 6 aktivitete, të gjitha janë realizuar, ose 100%. Për qëllimin Strategjik 3 ishin parashikuar 3 aktivitete dhe të gjitha janë realizuar, gjithashtu 100%.

Qendra realizoi një projekt rajonal të financuar nga Programi për zhvillim të barabartë rajonal për vitin 2025. Të gjitha aktivitetet u realizuan nga mesi i vitit 2025. Në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve publike komunale përmes blerjes së pajisjeve", ku ishin partner 5 komuna: Strugë, Ohër, Dibër, Kërçovë dhe Makedonski Brod, aktivitetet u përfunduan plotësisht për 3 komuna, ndërsa për disa aktivitete në komunat Ohër dhe Makedonski Brod ato janë transferuar në fillim të vitit 2026. Për komunën e Strugës u blenë dy kamioneta për nevojat e ndërmarrjes publike komunale për mbledhjen e mbeturinave në rrugë të ngushta dhe të vogla në qytet dhe komunë. Kamionetat mund të përdoren edhe për mbledhjen e fraksioneve të veçanta të mbeturinave për riciklimin e mbeturinave shtëpiake.
Për komunën e Dibrës u blen mini bager për nevojat e ndërmarrjes publike komunale "Standard", i cili do t'u shërbejë punonjësve dhe ndërmarrjes për riparimin e defekteve të vogla në tubacionet e ujësjellësit dhe kanalizimeve në qytet dhe komunë. Për komunën e Kërçovës u blenë 700 konteinerë plastikë 120 litër për ndarjen dhe selektimet të veçanta të mbeturinave nga shtëpitë. Për komunën e Ohrit u blen aparati për detektimin e humbjeve të ujit në sistemet

e ujësjellësit, i cili tashmë është në përdorim. Pajisjet tjera, dy prerës për tubacione dhe çekani elektrik, pritet të dorëzohen në fillim të janarit 2026. Për komunën e Makedonski Brodit, është blerë dhe dorëzuar në përdorim krah hidraulik teleskopik me mulçer për nevojat e ndërmarrjes publike komunale, ndërsa 3 pompa fekale pritet të arrijnë dhe montohen në shkurt 2026.

Përmes Programit për disparitete brenda dhe mes rajoneve nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale për vitin 2025, Qendra aplikoi me 4 projekte për blerjen e pajisjeve për ndërmarrjet publike komunale nga komunat Vevçan, Debrcë, Qendrës Zhupë dhe Pllasnicës.Për komunat Vevçan dhe Debrcë u blen makineri lëvizëse për pastrimin e tubacioneve të kanalizimeve. Për komunën e Plasnicës u blen dhe dorëzua një traktor i ri për ndërmarrjen publike komunale për mbledhjen dhe vendosjen e mbeturinave. Për komunën Qendër Yhupë u blen mini bager për ndërmarrjen publike komunale "Kale".

Në kuadër të skemës së granteve për projekte investuese me komponentë digjital, Qendra për zhvillim mori fonde shtesë për tre institucione publike për blerjen e pajisjeve:
Për Entin shëndetësore publike Kardiologji – Ohër, u blen aparati për test stres dhe tashmë është në përdorim. Për Entin shëndetësore publike Nefrologji – Strugë, u blenën tre aparate për hemodializë, hemodiafiltrim dhe hemofiltrim. Për Entin shëndetësore publike "Shën Erazmo" – Ohër, u blen aparati video për intubacion. Të gjitha pajisjet për këto tre institucione janë blerë në fillim të vitit 2025 dhe të gjitha janë dorëzuar dhe në përdorim.

Në kuadër të projektit "Përmirësimi i efikasitetit energjetik në RPJP", i financuar nga Programet ZHBR të Byros për zhvillim rajonal për vitet 2023/2024, aktivitetet u realizuan në komunën e Ohrit, në kopshte publike "Jasna Risteska" në objektet Lihnida dhe Rosica. Për shkak të mangësive në projekt, aktivitetet u zgjatën deri në vitin 2025, dhe deri më 31.12.2025 u përfunduan të gjitha punimet ndërtimore dhe ndërhyrjet. Në të dy objektet e kopshtit u rikonstruktuan gjithsej 10 tualete, duke përfshirë: rikonstruksion të dyshemeve, mureve dhe tavanëve, linjë të re ujësjellësi, instalime elektrike të reja në sanitare, pllaka të reja dhe elemente të reja sanitare.

Në bashkëpunim me donatorin UNDP, Qendra për Zhvillim të RPJP aplikoi projekt për përgatitjen e dokumentacionit teknik për infrastrukturën rrugore. Marrëveshja me UNDP u nënshkrua në fund të vitit 2023 dhe aktivitetet filluan në fillim të vitit 2024. Partnerë në projekt janë 5 komuna: Ohër, Kërçovë, Vevçan, Dibër dhe Pllasnicë. Për komunën e Ohrit, dokumentacion teknik u përgatit për pjesë të rrugës shtetërore A3 Ohër–Kosel, ku disa aktivitete u realizuan gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 dhe deri në mars 2025 të gjitha aktivitetet përfunduan dhe projektet bazë u dorëzuan tek komuna për aplikime të mëtejshme.

Komunat realizuan aktivitete të shumta për ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës rrugore dhe komunale. Po ashtu, një pjesë e komunave realizuan aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit teknik për infrastrukturën rrugore. Disa ndërmarrje publike komunale u pajisën me mekanizëm komunal dhe konteinerë për mbeturina.

Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përbëhet nga pjesa narrative dhe tabelare.

## I. PJESA NARRATIVE E RAPORTIT VJETOR

### 1. Lista e projekteve dhe aktiviteteve të realizuara

Kjo pjesë përmban listën e projekteve dhe aktiviteteve të realizuara në kuadër të çdo mase në veçanti, në pajtueshmëri me qëllimet strategjike dhe prioritetet e përcaktuara në Programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Pra, për çdo projekt dhe aktivitet të realizuar janë shënuar: titulli i plotë, periudha e saktë e realizimit, shuma e mjeteve të realizuara dhe shfrytëzuesi.

**Qëllimi strategjik 1 – Avancimi i ekonomisë dhe paritetit gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive krahasimore të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji, njohuri dhe inovacione të reja, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësi dhe zhvillimit rural**

Prioriteti 1.1 – Rritja e konkurrencës së ekonomisë rajonale

Masa 1.1.1 - Nxitja e shpirtit sipërmarrës tek të rinjtë e posaçërisht tek vajzat përmes trajnimeve dhe mbështetjes TIK dhe start-up bizneseve të reja

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.2 - Krijimi i një rrjeti informativ për zhvillim të inovacioneve në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.3 - Nxitja e unioneve dhe formimi i klasterave

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.4 - Nxitja e mundësive për shfrytëzimin e burimeve financiare të brendshme dhe të jashtme për NVM

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.1.5 - Brendimi i produkteve dhe shërbimeve që janë të njohura për rajonin

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 1.2 Fuqizimi dhe modernizimi i sektorit të NVM-ve

Masa 1.2.1 - Nxitja e iniciativave për ndryshime strukturore tek sektori i NVM në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.2 - Nxitja e specializimit të mençur për zhvillimin ekonomik të rajonit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.3 - Ruajtja e zejeve tradicionale dhe zhvillimi i bizneseve në zona rurale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.4 Nxitja e shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet subjekteve brenda vendit dhe jashtë

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.2.5. - Nxitja e sipërmarrjes tek gratë

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 1.3 Rritja e investimeve në rajon

Masa 1.3.1 Mapimi i potencialeve investuese në rajon

- nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 1.3.2 Nxitja e takimeve tek bashkësia e biznesit me investitorët potencial

- nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 1.3.3 Organizimi i manifestimeve për promovimin e biznes sektorin

- nuk ka aktivitet të realizuara

Prioriteti 1.4 Përmirësimi i hapësirës përmes zhvillimit të infrastrukturës

Masa 1.4.1 - Ndërtimi dhe rekonstruktimi i rrjetit rrugor në rajon

- Ndërtimi i rrugës në f.Pllasnicë, f.Dvorci dhe f.Pregllovë / Qeveria e RMV Nënprogrami AA / / janar – dhjetor 2025 / 10.870.581 DEN / qytetarët e Komunës së Pllasnicës

- Ndërtimi i rrugës qasëse në një pjesë të Pr.5 dhe një pjesë e Pr.8 në vb Pregllovë – Pllasnicë / Qeveria e RMV Nënprogrami AA / janar – dhjetor 2025 / 1.985.269 DEN / qytetarët e Komunës së Pllasnicës

- Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i rrugëve lokale në fshatin Pralenik – Komuna e Qendër Zhupës / Qeveria e RMV Nënprogrami AA / janar – dhjetor 2025 / 12.029.313 DEN / qytetarët e Komunës së Qendër Zhupës

- Rikonstruksioni i rrugës lokale në f.Zlesti deri në f.Ballçishtë – Komuna e Debërcës / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 9.926.800 DEN / qytetarët e Komunës së Debërcës

- Rikonstruksioni i rrugës lokale QENDËR-DEJKOV MOST në Komunën e Vevçanit / Qeveria e RMV Nënprogrami AA / janr – dhjetor 2025 / 2.626.038 DEN / qytetarët e Komunës së Vevçanit

- Ndërtimi i rrugëve qasëse Dame Gruev në Makedonski Brod / Programi i MVL për uljen e dispariteteve 2025 / qershor – dhjetor 2025 / 1.029.484 DEN / qytetarët e Komunës së Makedonski Brodit

- Ndërtimi trotuarit në një pjesë të rrugës “Marshali Tito” në Makedonski Brod / Komuna Makedonski Brod/ janar – dhjetor 2025 / 3.051.19 DEN / banorët e Komunës së Makedonski Brodit

- Rikonstruksioni i një pjese të rrugës lokale Strogomishti i Poshtëm në Komunën e Kërçovës / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 8.340.030 DEN / banorët e Komunës së Kërçovës

- Rikonstruksioni i një pjese të rrugës në f.Greshnicë / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 9.608.393 DEN / banorët e Komunës së Kërçovës

- Rikonstruksioni i rrugës në f.Peshtan – Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 4.902.359 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Rikonstruksioni i rrugës në f.Podmolje – Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 2.047.465 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Rikonstruksioni i rrugës në f.Lakoçerej i Poshtëm – Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 4.832.208 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Rikonstruksioni i rrugës lokale nga udhëkryqi për fshatin Ramne deri te kisha Shën Atanasij – Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 16.536.690 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Projekt themelor për objekt linear infrastrukturor rrugë lokale Leskoec – Lakoçerej i Poshtëm- Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 9.675.986 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Projekt themelor për rikonstruksionin e rrugës "Zdravko Çoçkovski" Komuna e Dibrës / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 4.294.045 DEN / banorët e Komunës së Dibrës

- Rikonstruksioni i rrugës lokale në fshatin Spas / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 7.569.652 DEN / banorët e Komunës së Dibrës

Masa 1.4.2 - Nxitja dhe zhvillimi i infrastrukturës TIK në rajon

- nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 1.4.3 - Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale në rajon

- Projekt themelor për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në f. Pllasnicë 65/16 krahu 11 / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 4.690.069 DEN / qytetarët e Komunës së Pllasnicës

- Ndërtimi i linjës së kanalizimit – krahu 27 në Komunën e Vevçanit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 1.816.027 DEN / banorët e Komunës së Vevçanit

- Ndërtimi i hapësirës publike dhe parkingut tek tregu i vjetër në Makedonski Brod / Programi i MVL për zvogëlimin e dispariteteve 2025 / qershor – dhjetor 2025 / 1.152.494 DEN / banorët e Komunës së Makedonski Brodit

- Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit në rr.Klenoec LTH Learnica – Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 24.453.760 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Projekt për përdorimin dhe mirëmbajtjen e hapësirës urbane dhe parkut në një pjesë të Kej Maqedonia – Komuna e Ohrit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor2025 / 24.948.315 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Projekt themelor për rikonstruksionin e ujësjellësit në fshatin Mogorçë, Komuna e Dibrës / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 14.092.544 DEN / banorët e Komunës së Dibrës

Masa 1.4.4 - Përgatitja e dokumentacionit teknik për infrastrukturë

- Përgatitja e dokumentacionit teknik për rikonstruktimin e një pjese të rrugës A3 Ohër – Leskoec – Kosel – Komuna e Ohrit / Fondi për dokumentacion teknik, UNDP, Qeveria suedeze, BZHR / janar 2024 – mars 2025 / 1.740.000 DEN / qytetarët e Komunës së Ohrit

Prioriteti 1.5 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Masa 1.5.1- Krijimi i një sektori modern dhe produktiv bujqësor në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.2 - Tejkalimi i problemeve aktuale në sektorin bujqësor, me qëllim për ta modernizuar

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.3- Nxitje dhe zhvillim i ushqimit organik

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.4 - Promovim të produkteve të njohura bujqësore dhe blegtorale nga rajoni dhe brendimi i tyre

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.5 Masa për tejkalimin e pasojave që vijnë nga ndryshimet klimaterike në sektorin e bujqësisë

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 1.5.6 Masa stimulese për rritjen e plantacioneve bujqësore autokone dhe kultivimi i llojeve të bimëve autokone

- nuk ka aktivitete të realizuara

**Qëllimi strategjik 2 - Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të të rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara**

Prioriteti 2.1. Përmirësimi i kualitetit të arsimit dhe përshtatja e nevojave në pajtim me kërkesat e tregut të punës

Masa 2.1.1 - Inicimi i programeve arsimore sipas nevojave të sektorit të biznesit, gjegjësisht tregut të punës

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.1.2 - Vendosja e pajisjeve laboratorike dhe kabineteve përkatëse bashkëkohore tek shkollat e mesme

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.1.3 - Nxitja e inovacionit në arsimin e mesëm

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.1.4 Rritja e kapacitetit të stafit mësimdhënës në shkollat e mesme dhe përfshirja në programet arsimore të BE-së

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.1.5. Krijimi i orientacionit të karrierës në shkollat e mesme duke eliminuar stereotipet gjinor

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 2.2 Nxitja e bashkëpunimit mes arsimit dhe biznes sektorit

Masa 2.2.1 - Inkurajimi i orëve arsimore praktike të detyrueshme në shkollat e mesme

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.2 - Vizita në panairet e teknikës dhe teknologjisë të destinuara për shkollat e mesme profesionale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.3 - Krijimi i bazave të profileve të nevojshëm nga arsimi i mesëm në APRMV dhe ndërmjetësimi i tyre në procesin e ofertës dhe kërkesës

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.4 - Rikualifikim, mësim gjatë gjithë jetës në përputhje me nevojat e sektorit të biznesit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.2.5 - Programi i mentorimit dhe praktikës sidomos për vajzat në STEM (inxhinieri, teknologji, industri) dhe për djemtë në arsim, mbrojtje sociale dhe përkujdes social.

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 2.3 Parandalimi i largimit të profesionistëve të rinj nga rajoni

Masa 2.3.1 - Krijimi i mundësive të punësimit për të rinjtë e arsimuar përmes masave stimuluese shtetërore që do të zbatohen nga komunat

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.3.2- Krijimi i masave stimuluese për punësimin e të rinjve në zonat rurale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.3.3 - Masat stimuluese për punësimin dhe zgjidhjen e kushteve sociale për personat e kthyer

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 2.4 Mundësi të barabarta për të gjithë në tregun e punës

Masa 2.4.1- Masa stimuluese për punësimin e femrave

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.4.2 - Krijimi i kushteve për qasje deri tek vendet e punës për kategoritë e rrezikuara sociale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.4.3 - Përfshirje sociale si sfidë për integrimet në BE

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.4.4 - Përkrahja e parimit të solidaritetit për kategoritë më të rrezikuara në shoqëri

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 2.5 Qasje e barabartë tek shërbimet për të gjithë qytetarët në rajonit

Masa 2.5.1 Rritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe qasje për të gjitha kategoritë e qytetarëve

- Përmirësimi i kushteve për turizëm shëndetësor me rikonstruktimin e ISHP Kardiologjisë-Ohër, furnizimi i pajisjeve dhe digjitalizimi / PR ZHBRQI MVL dhe SDC / dhjetor 2024 – mars 2025 / 908.600 DEN / Pacientë nga i gjithë shteti dhe shtetet fqinje

- Rikonstruktimi i ISHP Nefrologjisë – Strugë dhe krijimi i kushteve për turizëm shëndetësor në RPJP / PR ZHBRQI MVL dhe SDC / dhjetor 2024 – mars 2025 / 3.540.000 DEN / Pacientë nga i gjithë shteti dhe shtetet fqinje

- Pajisja e qendrës moderne për terapi fizikale në spitalin Shën Erazmo – Ohër / PR ZHBRQI MVL dhe SDC / dhjetor 2024 – mars 2025 / 1.853.000 DEN / Pacientë nga i gjithë shteti dhe shtetet fqinje

- Furnizimi i pajisjeve urbane lodra për fëmijë për parkun e fëmijëve në Qendër Zhupë / Programi BZHR – Zhvillimi i fshatrave / janar – dhjetor 2025 / 600.000 DEN / Fëmijët nga Komuna e Qendër Zhupës

- Ndërtimi dhe pajisja e hapësirave rekreative dhe parkut të fëmijëve në Komunën e Qendër Zhupës / Programi UNDP dhe Komuna e Qendër Zhupës / janar – dhjetor 2025 / 3.880.250 DEN / Fëmijët nga Komuna e Qendër Zhupës

- Rikonstruksioni i parkut në Komunën e Vevçanit / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 2.546.398 DEN/ qytetarët dhe fëmijët e Komunës së Vevçanit

- Furnizimi dhe montimi i shtyllave të drurit për ulje në tribunat e stadiumit të qytetit në Makedonski Brod / Komuna e Makedonski Brodit / janar – dhjetor 2025 / 417.927 DEN / banorët e Komunës së Makedonski Brodit

Masa 2.5.2 Përmirësimi i kujdesit shëndetësor primarë në zonat rurale të rajonit
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 2.5.3 Përfshirja sociale e të moshuarve dhe personave të pamundshëm
- nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 2.5.4 Përfshirja sociale për kategoritë e qytetarëve të izoluara nga shoqëria duke hapur qendra të për kujdesit ditor
- nuk ka aktivitet të realizuara

Masa 2.5.5 Krijimi i kushteve për pranimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe

- Rikonstruksioni dhe adaptimi i IPKF „Jasna Risteska“, objektet Rosica dhe Lihnida në Ohër (sanitaret, ujësjellës dhe kanalizimi) / Projekti për përmirësimin e efikasitetit energjetik në RPJP / Programi për ZHBR 2023/2024 – zhvillimi i rajoneve planore / janar – dhjetor 2025 / 8.071.123 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

Masa 2.5.6 Rritja e numrit të akomodimit të nxënësve dhe studentëve në objektet e organizuara – konvikte
- nuk ka aktivitet të realizuara

**Qëllimi strategjik 3 - Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë të avancuara janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të veçantë në RPJP**

Prioriteti 3.1 Përmirësimi i qasjes dhe rregullimi i lokaliteteve turistike

Masa 3.1.1 Përgatitja e dokumentacionit urbanistik për rregullimin e lokaliteteve turistike në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.1.2 Mapimi i rariteteve natyrore dhe kulturore në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.1.3 Infrastruktura rrugore në vendet turistike të përshtatura për personat me nevoja të veçanta

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.1.4 Sigurimi i informacionit, sinjalizimit dhe vizualizimit të atraksioneve turistike

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.1.5 Rivitalizimi i lokaliteteve të rëndësishme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 3.2 Tejkalimi i karakterit sezonal të turizmit në rajon

Masa 3.2.1 Krijimi i paketave turistike rajonale

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.2.2 Rishpërndarja e vizitorëve nga qendrat e njohura turistike në pjesën tjetër të rajonit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.2.3 Tërheqja e investimeve të brendshme dhe të huaja për zhvillimin e kapaciteteve akomoduese në brendësi të rajonit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.2.4 Zhvillimi dhe promovimi i manifestimeve lokale që do të jenë atraktive për vizitorët vendas dhe të huaj gjatë gjithë vitit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 3.3 Nxitja dhe zhvillimi i formave alternative të aktiviteteve dhe shërbimeve turistike

Masa 3.3.1 Zhvillimi i turizmit malor në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.3.2 Avancimi i turizmit speleologjik në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.3.3 Zhvillimi dhe avancimi i mundësive për aktivitete dimërore në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.3.4 Zhvillimi dhe avancimi i agro-turizmit në rajon

- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.3.5 Zhvillimi i bizneseve lokale si mbështetës i aktiviteteve turistike në brendësi të rajonit

- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 3.4 Përmirësimi i menaxhimit me destinacionet turistike

Masa 3.4.1 Krijimi i planeve nga NJVL për menaxhim me destinacionet
-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.2 Trajnimi i kuadrit për menaxhim me destinacionet turistike
-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.3 Tërheqja e fondeve për rregullimin e destinacioneve turistike lokale
-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.4 Strategji marketingu për promovimin e destinacioneve turistike lokale
-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.4.5 Krijimi i ofertave lokale për të vizituar destinacionet turistike
-nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 3.5 Mbrojtja e ambientit jetësor

Masa 3.5.1 Krijimi i sistemit rajonal integrues për menaxhimin me mbeturinat
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.2 Masa për zgjidhjen e problemit me qentë endacak në rajon
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.3 Mbrojtja e biodiversitetit në rajon
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.4 Masa për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.5 Masa për mbrojtjen ujërave nga ndotja

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi, montimi, përshtatja dhe instalimi i 3 pompave për ujëra fekal për stacionin pastrues në Komunën e Makedonski Brodit / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik 2025 – në vijim / 931.905 DEN / banorët e Komunës së Makedonski Brodit

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – furnizimi i aparatit për detektimin e defekteve në gypat e ujësjellësit / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik 2025 – në vijim / 873.200 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i aparatit prerës dhe qërues (Φ110-500 mm) dhe prerësit dhe qëruesit (Φ63-110 mm) / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik 2025 – në vijim / 174.451 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i çekiçit elektrik / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik 2025 – në vijim / 116.348 DEN / banorët e Komunës së Ohrit

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK Debërca përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i makinerive për mirëmbajtjen dhe pastrimin e sistemeve të kanalizimit në Debërc /

Programi i MVL për zvogëlimin e dispariteteve / maj – dhjetor 2025 / 1.113.224 DEN / banorët e Komunës së Debërcës

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK Eremja përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i makinerive për mirëmbajtjen dhe pastrimin e sistemeve të kanalizimit në Vevçan / Programi i MVL për zvogëlimin e dispariteteve / maj – dhjetor 2025 / 1.113.224 DEN / banorët e Komunës së Vevçanit

- Përforcimi i kapaciteteve komunale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës komunale në Komunën e Vevçanit / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i fshatrave / korrik – dhjetor 2025 / 186.500 DEN / banorët e Komunës së Vevçanit

Masa 3.5.6 Masa për mbrojtjen e tokës nga ndotja

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK Komunalec përmes furnizimit të pajisjeve Pllasnicë – Furnizimi i traktorit me kabinë për nevojat e NP "Komunalec" – Pllasnicë / Programi i MVL për zvogëlimin e dispariteteve / maj – dhjetor 025 / 1.157.478 DEN / banorët e Komunës së Pllasnicës

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK Kale përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i mini ekskavatorit për nevojat e NPK "Kale" – Qendër Zhupë / Programi i MVL për zvogëlimin e dispariteteve / maj – dhjetor 2025 / 1.312.632 DEN / banorët e Komunës së Qendër Zhupës

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i mini ekskavatorit me zingjirë për nevojat e Komunës së Dibrës / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik – dhjetor 2025 / 2.006.000 DEN / banorët e Komunës së Dibrës

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i 2 (dy) kamionaetave / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik – dhejtor 2025 / 1.385.993 DEN / banorët e Komunës së Strugës

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i kontejnerëve nga plastika prej 120 l / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik – dhejtor 2025 / 773.962 DEN / banorët e Komunës së Kërçovës

- Përforcimi i kapaciteteve të NPK përmes furnizimit të pajisjeve – Furnizimi dhe dorëzimi i dorës hidraulike teleskopike për traktor me mulçer dhe shtesë për kastrim për nevojat e Komunës së Makedonski Brodit / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i rajoneve planore / korrik – dhejtor 2025 / 567.000 DEN / banorët e Komunës së Makedonski Brodit

- Furnizimi i kamionetit për nevojat e ndërmarrjeve publike komunale në Makedonski Brod / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i zonave urbane / korrik – dhjetor 2025 / 547.520 DEN / banorët e Komunës së Makedonski Brodit

- Furnizimi i kontejnerëve për fshatrat ndërkufitare dhe malore në Komunën e Strugës / Programi për ZHBR 2025 – zhvillimi i zonave me nevoja specifike zhvillimore / korrik – dhjetor 2025 / 493.240 DEN / banorët e Komunës së Strugës

- Furnizimi i cisternës prej 8 t dhe cisternës prej 4 t për Komunën e Strugës / Programi UNDP / janar – dhjetor 2025 / 6.150.000 DEN / banorët e Komunës së Strugës

- Furnizimi i automjetit elektrik për fshirjen e rrugëve për nevojat e NPK në Komunën e Strugës / Programi UNDP / janar – dhjetor 2025 / 8.849.000 DEN / banorët e Komunës së Strugës

- Furnizimi i cisternës së vogël prej 4 t për larjen e rrugicave më të vogla në Komunën e Strugës / Programi UNDP / janar – dhjetor 2025 / 4.200.000 DEN / banorët e Komunës së Strugës

Masa 3.5.7 Marrja e masave për tejkalimin e problemeve që vijnë nga ndryshimet klimaterike
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.5.8 Masa për menaxhimin e rreziqeve që vijnë nga fatkeqësitë elementare
- nuk ka aktivitete të realizuara

Prioriteti 3.6 Përmirësimi i efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë

Masa 3.6.1 Masa stimuluese për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.6.2 Zvogëlimi i shfrytëzimit të derivateve fosile si energji në industri dhe amvisëri
- nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.6.3 Përmirësimi i energjisë efikase në objektet publike

- Përmirësimi i EE në objektet publike përmes shfrytëzimit të BRE në Vevçan / Programi i MVL për zvogëlimin e dispariteteve për vitin 2025 / maj – dhjetor 2025 / 1.427.800 DEN / banorët e Komunës së Vevçanit

- Ngrohje dhe klimatizim për SHMK "Mirko Mileski" dhe SHMK "Drita" në Komunën e Kërçovës / Qeveria e RMV Nën programi AA / janar – dhjetor 2025 / 20.387.139 DEN / nxënësit e këtyre dy shkollave

Masa 3.6.4 Masa stimuluese për energji efikase në amvisëri
-nuk ka aktivitete të realizuara

Masa 3.6.5 Mbështetje të iniciativave për prodhimin e energenteve alternative ekologjike
-nuk ka aktivitete të realizuara

Në kuadër të **Qëllimit strategjik 1** - Avancimi i ekonomisë dhe paritetin gjinor përmes shfrytëzimit të përparësive krahasimore të burimeve njerëzore dhe materiale, përmirësimi i infrastrukturës, aktivitete investuese në NVM me teknologji të reja, njohuri dhe inovacion, qasje deri te financat dhe qëndrueshmëri në ambientin jetësor, bujqësi dhe zhvillim rural, janë realizuar gjithsej **23** aktivitete.

Në kuadër të projektit **Qëllimi strategjik 2** - Arsim konkurrues sipas nevojave të bashkësive lokale, bashkësisë së biznesit dhe tregut të punës, avancimi i barazisë gjinore dhe përmirësimi i qasjes deri te arsimimi dhe shërbimet sociale të qytetarëve, në drejtim të zvogëlimit të largimit të të rinjve dhe de popullimit, me punësim produktiv dhe mbrojtje sociale të fëmijëve, personave të pamundshëm dhe të varur në aspekt social dhe kategorive të rrezikuara, janë realizuar **8** aktivitete.

Në kuadër të **Qëllimi strategjik 3** - Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore, ambienti jetësor i mbrojtur dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë të avancuara janë faktorë për zhvillim të qëndrueshëm të veçantë në RPJP, janë realizuar gjithsej **20** aktivitete.

Numri i përgjithshëm i aktiviteteve të realizuara nga projektet për të tre qëllimet strategjike është **51**.

## 2. Sigurimi i transparencës në realizimin e Programit

Në këtë pjesë janë prezantuar të dhënat për rezultatet e arritura në pjesën e transparencës në realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor ka web faqen e saj (www.southwestregion.mk) në të cilën rregullisht publikohen informacione për të gjitha aktivitetet të cilat realizohen nga ana e Qendrës. Gjatë vitit 2025 gjithsej janë publikuar 28 publikime (lajme, seanca, takime, projekte).

Në lidhje me punën e Qendrës për zhvillim, janë vendosur materialet nga projektet e realizuara nga viti 2009 deri në fund të vitit 2025 (https://southwestregion.mk/proekti/), me aktivitet kryesore, indikatorët dhe rezultatet nga projektet, si dhe raportet dhe foto nga të njëjtat. Të gjitha materialet janë vendosur në 3 gjuhë (maqedonase, shqipe dhe angleze).

Për punën e Këshillit për zhvillim, u vendosen materialet siç janë: Ftesa dhe Rendi i ditës për seancat e Këshillit për zhvillim të RPJP, lista e pjesëmarrësve të ftuar në seanca, Procesverbalet, fotografitë, materialet nga projektet etj. Gjatë vitit 2025 u mbajtën 4 seanca të Këshillit. Për të njëjtat janë publikuar informacionet përkatëse në web faqen e Qendrës. (si shtojcë linku nga Seancat: https://southwestregion.mk/odnosi-so-javnosta/sednici/).

Në web faqen e Qendrës për zhvillim, gjatë vitit 2025, u vendosen edhe materiale të tjera, dokumente, programi, plani për punë i Qendrës, si dhe realizimi i Programit për zhvillim. Mes tyre, janë vendosur: Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim për vitin 2024 (në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Plani aksionar për realizimin e Programit për zhvillim për vitin 2025 (në gjuhën maqedonase dhe shqipe), Llogaritë përfundimtare për vitin 2024, edhe atë për Qendrën për zhvillim dhe për Projektin: ZHBR i qëndrueshëm dhe inkluziv dhe Projektin: Dokumentacion teknik për rrugë dhe ujësjellës-UNDP (në gjuhën maqedone), Plani financiar vjetor për vitin 2025 dhe Raporti financiar vjetor për vitin 2024 (në gjuhën maqedone dhe shqipe).

Në lidhje me furnizimet publike, u publikua Plani për furnizime publike për vitin 2025 (në gjuhën maqedone) dhe për vitin 2026. Në këtë pjesë është e rëndësishme të përmendet, se web faqja e Qendrës për zhvillim është e harmonizuar me sistemin elektronik për furnizime publike (e-nabavki), dhe të gjitha procedurat e shpallura në sistemin e-nabavki shpallen edhe në ueb faqen e Qendrës për zhvillim. (linku:https://southwestregion.mk/javni-nabavki/).

Gjithashtu, në ueb faqe janë publikuar edhe të dhëna për bashkësinë e biznesit (të ndara në 12 sfera të veprimtarisë), Shoqëria civile dhe Institucionet shkencore në rajon (shkollat fillore, të mesme dhe të larta nga rajoni). Për komunitetin e biznesit janë vendosur të dhëna dhe kontakte për 921 kompani, për shoqërinë civile janë të vendosur të dhëna për 1164 shoqata, për institucione arsimore janë vendosur të dhëna për 39 shkolla fillore, 9 të mesme dhe 6 institucione të arsimit të lartë.

Në "Facebook" faqen e Qendrës për zhvillim (link nga faqja e "Facebook": https://www.facebook.com/Jugozapadenplanskiregion), gjatë vitit 2025, janë publikuar dhe shpërndarë gjithsej 21 informacione për punën e Qendrës, shpallje dhe thirrje, për Rajonin, për komunat dhe për trajnime. Në fund të vitit 2025 faqja e FB e Qendrës për zhvillim të RPJP kishte 2.245 ndjekës. Numri i përgjithshëm i vizitave gjatë vitit 2025 është 36.900.

Nga fillimi i vitit 2022 Qendra për zhvillim e rajonit planor Jugperëndimor ka kanalin e vet në YouTube në cilin ka publikuar 19 video materiale që kanë të bëjnë me aktivitetet Qendrës dhe

promocionin e biznes sektorit nga rajoni Jugperëndimor. Nga numëri i përgjithsëm i 19 videove, gjatë vitit 2025 janë përgatitur dhe janë publikuar 3 video. Numri i përgjithshëm i shikueshmërisë së video materialeve të publikuara është 27.599.

Qendra për zhvillim, në kuadër të mundësive të veta, për aktivitetet e rëndësishme që kanë të bëjnë me përditshmërinë, ishte e mbuluar nga mediumet nacionale, rajonale dhe lokale si ata të shkruara edhe elektronike. Është e rëndësishme të theksohet se kemi pasur pjesëmarrje të rregullt me inserte, të cilat kanë të bëjnë me aktivitete konkrete të projekteve, gjatë vitit 2025, kemi patur në Agjencionin Informativ të Maqedonisë – MIA, përmes rrjetit të tyre të gazetarëve nga Ohri, Struga, Kërçova dhe Dibra, si edhe në Radio Televizionin e Maqedonisë, ndërsa tek mediumet e shkruara tek gazeta Nova Makedonija dhe Koha.

Qendra për zhvillim, bashkëpunoi me një numër të madh të mediumeve rajonale, siç janë stacionet televizive TVM nga Ohri, TV Gurra nga Kërçova dh TV Zhupa nga Dibra, kryesisht u transmetuan deklaratat e kryetarit të Këshillit për zhvillim të RPJP, kryetarët e komunave dhe drejtoresha e Qendrës për zhvillim, për disa evente të rëndësishme për Rajonin, për fillimin e realizimit të aktiviteteve të projekteve, shprehjen e mendimeve për tema tjera, si dhe pjesëmarrjen në emisione. Nga internet portalet informacione të rregullta për Qendrën ka transmetuar Ohridnews, i cili e mbulon të gjithë rajonin dhe është një nga internet-mediumet më të rëndësishme në shtet.

Gjatë vitit 2025 në mediume u publikuan 20 shpallje për aktivitete të ndryshme të lidhura me Këshillin për zhvillim, Qendrën për zhvillim dhe rajonin Jugperëndimor. Nga ato 17 janë lajmërime për publikun, 3 deklarata për mediume.

## 3. Sigurimi i participimit në realizimin e Programit

Në këtë pjesë prezantohen të dhënat për rezultatet e arritura në pjesën e participimit, si një nga parimet e përcaktuara ligjore të politikës për zhvillim të barabartë rajonal.

Duhet t'i jepet një rëndësi e veçantë procesit të përgatitjes, mbarëvajtjes dhe rezultateve nga puna e forumeve rajonale në bashkësi. Paraprakisht, duhet të ceket numri i forumeve rajonale të mbajtura, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në forumet rajonale, numri mesatar i pjesëmarrësve për çdo forum të mbajtur, si dhe struktura e të dhënave të pjesëmarrësve.

Gjithashtu, është e nevojshme të ceket edhe pjesëmarrja në përqindje e projekteve të cilat zgjidhen në forume nga numri i përgjithshëm i projekteve të realizuara nga ana e Qendrës për zhvillim të rajonit planor.

Për veç kësaj, për pjesën e projekteve dhe aktiviteteve ku nuk janë realizuar forume rajonale në bashkësi duhet të theksohet: a duhet, si dhe në çfarë raste duhet të zbatohen metoda dhe mekanizma të tjerë për participim.

Participimi për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është një nga principet themelore i cili zbatohet nga fillimi i funksionimit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor. Çdo vit Qendra organizonte punëtori planifikuese në të cilën merrnin pjesë përfaqësues nga të gjithë palët e interesuara në rajonin planor Jugperëndimor. U identifikuan problemet në rajon dhe u propozuan zgjidhje nga ana e përfaqësuesve të komunave, ndërmarrjet publike, biznes sektori, organizatat joqeveritare, institucionet arsimore dhe shëndetësore, dhe persona individual të interesuar. Të gjitha projekt idetë e gjeneruara u

harmonizuan me qëllimet strategjike dhe prioritetet me Programin për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Me fillimin e implementimit të projektit "Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv", dhe me ndryshimet me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal, këto punëtori planifikuese u shëndrruan në forume rajonale në përputhje me Agjencionin Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe BNJVL. Në forume u angazhuan moderatorë të çertifikuar nga BNJVL dhe në pajtueshmëri me rregullat, ftesa dhe rendi i ditës u dërgohet të gjithë palëve të interesuara nga rajoni. U organizuan dy forume me numër të caktuar të tavolinave të punës sipas fushave prioritare. Në sesionin e parë të forumit u identifikuan problemet dhe u propozuan zgjidhjet. U krijuan grupet e punës të cilat punuan në koncept projektet e propozuara dhe të njëjtët u prezantuan para pjesëmarrësve në sesionin e dytë të forumeve. Në sesionin e dytë të gjithë pjesëmarrësit me të drejt vote votuan dhe me këtë e krijuan listën e prioriteteve të projekteve për rajonin.

